




**IPARD**  
EU4 Rural Areas



# **RREGULLAT E ZBATIMIT TË KONTRATËS SË GRANTIT**

---

## **PROGRAMI IPARD II**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E FINANÇAVE




**azhbr**  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM | AGJENCIA  
BUJQËSOR DHE RURAL | IPARD

Ky aktivitet bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Shqiptare  
përmes masës së Asistencës Teknike



## **BAZA LIGJORE PROGRAMI IPARD 2014 -2020**

- 1.** Rregullorja (BE) nr. 231/2014, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 mars 2014, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- 2.** Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 mars 2014, që përcakton procedura dhe rregulla të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së, për financimin e masave të jashtme.
- 3.** Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 447/2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 231/2014, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- 4.** Ligj nr.37/2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II).
- 5.** Ligj nr.30/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe zhvillimi rural" (IPARD).
- 6.** Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural".
- 7.** Programi i Zhvillimit Rural 2014 - 2020 i Instrumentit të Asistencës Parazgjerimit (IPA).
- 8.** Kontrata e Grantit ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe përfituesit të fondeve të Programit IPARD II.



## **ÇFARË ËSHTË PROGRAMI IPARD**

Programi i Zhvillimit Rural 2014 - 2020 është një program shumëvjeçar në kuadër të Instrumentit të Asistencës Parazgjerimit (IPA).

IPARD fokusohet veçanërisht në zonat rurale dhe sektorët agroushqimor të vendeve në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE).

*Cilat janë objektivat e përgjithshme të Programit IPARD*

- ❖ Mbështetjen e investimeve në sektorin agro-ushqimor, me synim përmirësimin e konkurrueshmërisë, përbushjen e standardeve të BE-së dhe respektimin e standardeve të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit;
- ❖ Mbështetjen e investimeve në zonat rurale, me synim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e bizneseve që çojnë në përmirësim të mundësive të punësimit dhe të përfshirjes sociale.

## **CILI ËSHTË BUXHETI I PROGRAMIT IPARD II**

<b>Buxheti total publik i Programit IPARD II</b>	<b>94,337,255 Euro</b>
❖ Kontributi i Bashkimit Evropian	<b>71,000,000 Euro</b>
❖ Kontributi i Qeverisë Shqiptare	<b>23,337,255 Euro</b>

## **CILAT JANË STRUKTURAT QË ZBATOJNË PROGRAMIN IPARD II**

- ❖ **Struktura Operuese** – përgjegjëse për funksionet operacionale:
  - Autoriteti Menaxhues, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
  - Agjencia IPARD – Agjencia Për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
- ❖ **Struktura Menaxhuese** – përgjegjëse për funksionet e menaxhimit dhe kontrollit:
  - Zyrtari Kombëtar Autorizues, në Ministrinë e Financave, nëpërmjet:
    - Zyrës Mbështetëse për ZKA; dhe
    - Fondit Kombëtar.

## ***SI KRYHET MBIKËQYRJA, KONTROLLI, AUDITI DHE MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE***

- ❖ Programi IPARD II dhe të gjitha operacionet dhe kontratat në zbatim të Programit janë objekt mbikëqyrjeje, kontrolli dhe auditit nga Komisioni Evropian, përfshi Zyrën Evropiane Anti-Mashtrim (OLAF) dhe auditet e Gjykatës Evropiane të Auditëve.
- ❖ Agjentët e autorizuar dhe përfaqësuesit e Komisionit dhe të OLAF-it kanë të drejtë të kryejnë çfarëdo verifikimi teknik dhe financiar që Komisioni apo OLAF-i e çmon të nevojshme për mbikëqyrjen apo rishikimin e zbatimit të programit, aksionit apo kontratës, përfshirë vizita në terren dhe në ambientet ku zbatohen aktivitetet e financuara prej IPA II. Për të garantuar mbrojtjen efikase të interesave financiare të BE-së, Komisioni dhe OLAF-i mund të kryejnë kontrole në terren dhe dokumentare, si edhe inspektime sipas Rregullores nr. (EU, Euratom) 883/2013 dhe Rregullores (KE, Euratom) nr. 2185/199.
- ❖ Nëse pjesëmarrësit në aktivitetet e financuara nga IPA II kundërshtojnë kontrollin në terren apo inspektimin, Shqipëria që vepron në përputhje me rregullat kombëtare, u siguron inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmën e nevojshme që ata të kryejnë detyrën e tyre në kryerjen e kontrollit në terren dhe inspektimit.

### ***KONTROLLET DHE AUDITET E PËRSHKRUARA MË LART JANË TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË MARRËSIT QË KANË PËRFITUAR FONDE TË PROGRAMIT IPARD.***

- ❖ Strukturat e ngritura për menaxhimin dhe zbatimin e Programit IPARD, në përputhje me nenin 60(3) të Rregullores Financiare, parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë parregullsitë dhe mashtrimet gjatë menaxhimit dhe zbatimit të Programit IPARD. Për këtë qëllim, struktura përkatëse kryen kontrole ex-ante dhe ex-post, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, që të garantohet se aksionet e financuara prej buxhetit janë kryer me efektivitet dhe zbatuar me korrektësi. Struktura përkatëse rikuperon fondet e paguara padrejtësisht dhe ngre padi gjyqësore kur është e nevojshme.

## ***CILAT JANË DETYRIMET E PËRFITUESIT PAS MARRJES SË PAGESËS PËRFUNDIMTARE?***



- ❖ Investimet e kryera janë objekt i verifikimeve ex-post për të verifikuar respektimin e angazhimeve të ndërmarra nga përfituesi. Verifikimi ex post kryhet brenda pesë viteve nga data kur përfituesi merr pagesën e fundit. Gjatë periudhës pesëvjeçare, të gjitha investimet kontrollohen të paktën një herë.
  
- ❖ Projektet e investimeve në kuadrin e programeve të zhvillimit rural mbeten të pranueshme për financimin e BE-së, me kusht që të mos i nënshtrohen ndonjë modifikimi thelbësor brenda pesë viteve nga pagesa përfundimtare nga AZHBR. Modifikime thelbësore të një projekti janë ato që rezultojnë në:
  - a)* ndërprerjen apo zhvendosjen e një aktiviteti prodhues jashtë zonës gjeografike të mbuluar prej programit IPARD II;
  - b)* ndryshim të pronësisë që i jep avantazh të padrejtë një firme apo organi publik;
  - c)* ndryshim thelbësor që prek natyrën, objektivat apo kushtet e zbatimit, që çojnë në çënimin e objektivave fillestarë.

## **PRA:**

- ✓ Përfituesi është i detyruar të mos ndryshojë qëllimin e objektit të investimit të përcaktuar në kontratën e grantit.***
- ✓ Përfituesi është i detyruar të mos ndryshojë vendndodhjen e objektit të investimit të përcaktuar në kontratën e grantit.***
- ✓ Përfituesi është i detyruar të mos tjetërsojë, marrë me qira ose japë objektin e investimit të përcaktuar në kontratën e grantit.***

- ✚** Për çdo verifikim në vend përgatitet një raport kontrolli që bën të mundur shqyrtimin e hollësive të verifikimit të kryer. Raporti përcakton, në veçanti:
  - a)*** masat dhe aplikimet apo kërkesëpagesat që janë kontrolluar;
  - b)*** personat e pranishëm;
  - c)*** nëse i është dërguar njoftim paraprak përfituesit; dhe kur
  - d)*** rezultatet e verifikimit dhe, kur është e nevojshme, ndonjë vërejtje;
  - e)*** matje të tjera kontrolli që do të kryhen.
  
- ✚** Në rastin e verifikimit në vend, përfituesit i jepet mundësia të firmosë raportin gjatë kontrollit që të vërtetohet prania e tij gjatë kontrollit, si edhe të shkruajë vërejtje. Kur nuk konstatohet ndonjë mospërputhje, përfituesit i jepet një kopje e raportit të kontrollit.



- 
- 
- *Përfituesi është i detyruar të dërgojë informacion/të dhëna me kërkesë të AZHBR.*
  - *Përfituesi është i detyruar të ofrojë akses të plotë në dokumentacionin, ndërtesat, ambientet, pajisjet dhe pronën që kanë të bëjnë me investimet për personat e autorizuar të Agjencisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Komisionit Evropian, Gjykatës së Audituesve, si dhe Autoritetit të Auditimit gjatë kryerjes së kontrollit në vend dhe mbikëqyrjes.*
  - *Përfituesi në rast ndërtimi ose rindërtimi është i detyruar të mbajë dosjen teknike të punimeve në përputhje me ligjin kombëtar për ndërtimin ose rindërtimin,*
  - *Përfituesi ose përfaqësuesit e tij/saj i autorizuar janë të detyruar të identifikohen me kërkesë të personave të autorizuar të AZHBR gjatë kryerjes së kontrollit në vend.*
  - *Përfituesi është i detyruar të mbajë dokumentacionin origjinal që lidhet me objektin për të cilin ka përfitur fondet.*
  - *Përfituesi është i detyruar të menaxhojë në mënyrën e duhur dokumentacionin – të mbajë regjistrime të veprimeve/operacioneve të kryera, faturave, etj.*
  - *Përfituesi është i detyruar të kryejë veprimet e kontabilitetit/mbajtjen e llogarive/të dhënat e kontabilitetit sipas kërkesave të legjislacionit kombëtar dhe për nevojat e shërbimeve të Agjencisë dhe Ministrisë.*
  - *Përfituesi është i detyruar të shlyejë taksën e pronës, detyrimet tatimore, kontributet shëndetësore, sigurimet e pensionit dhe paafësisë për punë si dhe detyrimet e kërkuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.*
  - *Përfituesi është i detyruar të lëshojë fatura tatimore shitje gjatë ushtrimit të aktivitetit.*
  - *Përfituesi është i detyruar që: “statusi i biznesit të tij të jetë aktiv”.*





## **CILAT JANË DETYRIMET/PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME VIZIBILITETIN?**

- ❖ Për projektet e mëdha (> 100.000 EUR) kërkohet tabelë e përherëshme me një madhësi minimale A3 e vendosur në vend lehtësisht të dukshëm për publikun, siç është zona e hyrjes së ndërtesës, pasi projekti të ketë përfunduar, brenda 3 muajve pas përfundimit të punimeve. Tabela informuese duhet të jetë bërë nga material i qëndrueshëm, që zgjat të paktën gjatë një periudhe 5 vjeçare pas pagesës së fundit të përfituesit. Kërkesat për tabelën e përherëshme janë:

➤ ***Duhet të ketë fjalinë e mëposhtme:***

***'Ky [projekti] u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian'; dhe duhet të ketë stemën e BE-së.***

- ❖ Gjatë 5 viteve pas përfundimit të investimit, pajisjet/asetet e bashkëfinancimit nga IPARD (e të gjitha kategorive të projekteve), duhet të shënohen qartë me 'shënues' (stickers) që tregojnë se ato janë të bashkë-financuara nga asistenca IPARD / BE.
- ❖ Tabelat, posterat, pllakatat dhe faqet e internetit (shpjeguese), duhet të përmbajnë një përshkrim të projektit / veprimtarisë duke treguar që projekti është mbështetur nga IPARD dhe duke përfshirë emblemën e Bashkimit Evropian. Ky informacion duhet të marrë të paktën 25% të tabelave, pllakatave ose faqeve në internet. Aty ku duhet të përdoret emblema e Bashkimit Evropian, është e detyrueshme të shtohet një referencë e qartë për IPARD si më poshtë:



**IPARD**  
EU4 Rural Areas


## **CILAT JANË TË DREJTAT E AZHBR NË LIDHJE ME VIZIBILITETIN?**

- ❖ AZHBR ka të drejtë të njoftojë në faqen e internetit informacionin e mëposhtëm mbi Përfituesit:
  - Emri dhe mbiemri (kur Përfituesi është person fizik) ose emrin e plotë ligjor të regjistruar (kur Përfituesi është person juridik),
  - Bashkinë dhe qarkun ku banon apo është i regjistruar Përfituesi, kodin postar.
  - Shumën e fondeve në lekë të paguara sipas programit IPARD 2014-2020.

## **CILAT JANË RASTET KUR KËRKOHET KTHIMI I FONDEVE NGA PËRFITUESIT?**

- ❖ AZHBR ka të drejtë të kërkojë kthimin e fondeve nëse Përfituesi:
  - Ka dorëzuar dokumente të falsifikuara dhe i ka paraqitur si bazë për marrjen e fondeve nga Programi IPARD 2014-2020, ka përdorur/përdor fonde të tjera të BE-së ose fonde të tjera vendase ose të huaja me qëllim financimin e të njëjtit investim në formën e granteve,
  - Ka tjetërsuar, dhënë ose marrë me qira, ose ka ndryshuar qëllimin e objektit të investimit të Kontratës së Grantit,
  - Ka ndryshuar vendndodhjen e objektit të investimit të Kontratës së Grantit,
  - Në rast se është paguar më shumë se ç’duhej për shkak të gabimit administrativ të AZHBR,
  - Nuk ka siguruar akses të plotë në dokumentacionin, ndërtesat, ambientet, pajisjet dhe pronën që kanë të bëjnë me investimin për personat e autorizuar të AZHBR, Ministrisë së Financave, Komisionit Evropian, Gjykatës së Audituesve si dhe Autoritetit të Auditimit gjatë kryerjes së kontrollit në vend dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Kontratës në çdo kohë gjatë vlefshmërisë së Kontratës së Grantit;
  - Nuk ka vendosur tabelën që tregon se investimi financohet nga Programi IPARD 2014-2020 brenda 5 ditëve nga ekzekutimi i pagesës dhe për aq kohë sa kjo Kontratë është në fuqi; dhe
  - Në situata të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në të cilin bazohet zbatimi i Programit IPARD II.
- ❖ AZHBR ka të drejtë, në rast të kthimit të fondeve të përlogarisë një interes duke filluar nga dita pas skadimit të afatit të përcaktuar në njoftimin për kthimin e fondeve të nxjerrë nga AZHBR. AZHBR llogarit interesin në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 42, paragrafi 1 pika (c) të Marrëveshjes Sektoriale.
- ❖ AZHBR ka të drejtë të nisë procedurat ligjore në rast se përfituesi nuk ka kthyer shumën e marrë nga fondi brenda 15 ditëve pas marrjes së njoftimit për kthimin e shumës.





**Për më shumë informacion na kontaktoni në:**

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.2, Tiranë.

E-mail: [info@bujqesia.gov.al](mailto:info@bujqesia.gov.al)

[www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al)

[www.ipard.gov.al](http://www.ipard.gov.al)

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

Rr. "Muhamet Gjolllesha", Nr.56, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 28 318 | Fax: +355 4 22 28 318

E-mail: [info@azhbr.gov.al](mailto:info@azhbr.gov.al)

<https://azhbr.gov.al/> | [www.ipard.gov.al](http://www.ipard.gov.al)

**Denonconi parregullsi në adresën e e-mailit:**

[raportparregullsi@azhbr.gov.al](mailto:raportparregullsi@azhbr.gov.al)